**Republika e Kosovës**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

12 Nr.060/01-50488 dt. 19/11 2020

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 26.11.2020 (e Enjte ) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kulturës të Komunës.

**THËRRET**
**MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

Mbledhja do të ketë këtë:

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.10.2020.
2. Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Propozim Vendim për rrënimin e ish objektit të Komunës,si dhe objekteve tjera përcjellëse.
4. Propozim Vendim për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale.
5. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrate Gllogoc.
6. Model Kodi i Etikës
7. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021
8. Të ndryshme.

Drenas, 19.11.2020

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 060- 49466 dt. 12. 11 2020

**Mbledhja e rregullt**
**Kuvendi Komunal**
**30. 10.2020**

**PROCESVERBALI**

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **30.10.2020**
**Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues**
**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30, anëtarë.**
Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Betimi i asamblistit/ës së re znj. Antigona Istogu nga Partia Demokratike e Kosovës „PDK"duke e zëvendësuar anëtaren e Kuvendit Komunal pas dorëheqjes znj. Arta Xhylani në Kuvendin Komunal Drenas.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 23.09.2020.
3. Raporti Financiar i Zhvillimit Të Buxhetit Janar Shtator 2020.
4. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 12-400-40369,të datës. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
5. Propozim Vendim shfuqizimin e Vendimit 12-400-40360, të dt. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
6. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme ( njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
7. Propozim Vendim për këmbimin e pronave të paluajtshme (ndjesive të ndërtesave-banesave) në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
8. Propozim Vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme ( njësive të ndërtesave – banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
9. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme të hekurudhave të Kosovës (Shoqëri Aksionare ) për parcelat nr. 953-1,961-0,956-0, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Drenas (Gllogoc).
10. Propozim Vendim për transfero të mjeteve nga projekti rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi i sheshit të qytetit në projektin mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike.
11. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës,të cilat janë nënë menaxhimin e AKP-së, në zonën Kadastrale Korroticë të Epërme.

12. Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës për Kompaninë Fer Petrol.
13. Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës për Kompaninë Elkos shpk.
14. Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës personit fizik Ragip Veseli.
15. Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës ,zona kadasatrale Arllat për Kompaninë IP Kos shpk.
16. Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës zona kadastrave Gllogoc për Kompaninë IP Kos shpk.
17. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 30.10. 2020 ishin: Kryetari i Kuvendit Ramiz Lladrovci, Shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, këshilltarët e KK, gazetari i grupit Koha përfaqësues të, Zyrës se Informimit si dhe Drejtorët e Drejtorive përkatëse.

**Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** përshëndeti të gjithë të pranishmit, para se me shkua me rëndin e ditës znj. Arta Xhylani ka dhënë dorëheqje si asamblistë si anëtare e Kuvendi Komunal për arsye personale dhe profesionale dhe në renditje sipas votave është Antigona Istogu atëherë unë e kisha ftuar Antigonen të ngritët ne këmbe dhe të bëjë betimin , të bëjmë ndryshimin dhe pastaj te vazhdojmë me rëndin e ditës. Unë, Antigona Istogu ,betohem {ose deklarojë solemnisht} se do ti kryej, më nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës se Drenasit{Gllogoc}, në mënyrë që te sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.
**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj**-Vazhdojmë me rendin e ditës, kemi dërgua edhe disa propozime që ju kemi përcjell me imell siç është : 12.Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës për Kompaninë Fer Petrol.
13.Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës për Kompaninë Elkos shpk.
14.Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës personit fizik Ragip Veseli.
15.Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës ,zona kadasatrale Arllat për Kompaninë IP Kos shpk.
16.Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës zona kadastrave Gllogoc për Kompaninë IP Kos shpk.
konstatoj se prezent në mbledhje janë 30, pjesëmarrës. Prezantoi rendin e ditës, a ka dikush diçka rreth rendit të ditës jo hedhim në votim.
Pika e 10. Propozim Vendim për transfero të mjeteve nga projekti rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi i sheshit të qytetit në projektin mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike .Kërkohet nga drejtoria përkatëse që te largohet kjo pike nga rendi i ditës
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-** fjalën e merr Beqir Kiqina .

**Beqir Kiqina** –faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë kam një shqetësim sa i përket transmetimit të seancave ne televizion sepse që gjashte a shtate muaj seancat që kemi mbajt në këtë salle nuk janë transmetuar në televizion dhe si mundemi me i informuar qytetaret për pikat e rendit të ditës është përgjegjësi e juaja kryesues me pas transparencë ty po tu ju faleminderit.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**-jemi në kohë pandemie dhe e kemi të rekomanduar nga IKSHKP që seancat me u mbajt në hapësira me të mëdha për shkak të distancës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj** fjalën e merr: **Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** –nëse e merrni përgjegjësin ju për me u mbajt seancat ne sallën e kuvendit aty ku ka kamera sepse transparenca për mua është gjithçka ,prandaj jemi shpall kampion për performancen me të mirë në transparence komunale, hedheni në votim dhe unë jam i gatshëm ne këtë moment me shkuar ne sallë n e kuvendit ,por nëse e merrni përgjegjësin ju për me i shkel rekomandimet e IKSHKP –se.

**Beqir Kiqina** –unë nuk po them me i mbajt në sallën e kuvendit por mundeni me i ftua mediat ose me i improvizua kamerat këtu të paktën ne foltoren kryesore me u dëgjuar fjalimet.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** –mbledhjet janë publike edhe të gjitha mediat janë te lira me ardh me i përcjell mbledhjet për aq kohë sa nuk e pengojnë punën e kuvendit ,nëse nuk i thirrni kamerat ne nuk kemi buxhet me paguar askënd sepse qeveria na ka jep linkun edhe përmes linkut transmetohen mbledhjet në situata të tilla unë nuk mund me krijua kushte tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- ju ftoj me votua rendin e ditës me propozimet dhe ndryshimet që pika dhjete të tërhiqte nga rendi i ditës.

**Petrit Gashi** –duke pasur rendësin që ka dhënia ne shfrytëzim sepse ato prona nuk po jepen për 99 ditë por për 99 vite është mirë me e thirr një seancë te veçante për me trajtua pikërisht çështjen e pronave të pa luajtshme që jepen ne shfrytëzim që jepen për 99 vite e jo sot me ju bashkëngjit kësaj seance ,pra kërkoj edhe nga asamblistë edhe nga ju që ti tërhiqni ato pika të rendit te ditës të gjitha.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**-faleminderit zotëri Gashi ne jemi brenda rregullores dhe janë ndjek të gjitha procedurat dhe ardhja si propozime janë komplet brenda ligjit.

**Petrit Sinani** – përshëndetje për të gjithë normalisht që shtatë pika janë shumë , por sikur te na kish ardh materiali ne formën si duhet sepse unë nuk po mundem me lexuar se di a po mundet dikush nga koleget me lexuar e para e dyta imellat nuk janë duke funksionu qe dy dite sepse unë kam provua me hap imell nuk kam mund me e hapet ,sa i përket rendit të ditës normalisht kur është interesi i përgjithshëm të gjithë jemi pro faleminderit.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**-sa i përket imellave ne nuk jemi përgjegjës e kemi zyrtarin qe është i gatshëm në çdo kohe ti rregulloi imellat kur keni probleme.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj** –hodhi ne votim rendin e ditës :

**Për votuan 23 , Abstenim 3 , Kunder** 0

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 2.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.09.2020. diskutime nuk pati hedhim në votim, pra kjo pikë votohet në mënyrë unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**-hapi për diskutim **3.**Raporti Financiar i Zhvillimit Të Buxhetit Janar Shtator 2020.

Drejtori i financave Shyqiri Bublaku –faleminderit sa i përket te hyrave te vitit 2020 për shkak te pandemisë nga kuvendi i komunës te shume taksave për veprimtarinë ekonomike që është

shuma dikun **403.600.00** kemi pasur një shkurtim te realizimit te hyrave vetanakë qe realizimi për periudhën për te cilën po raportojmë Janar-Shtator ,të hyrat drektë komunale kemi shumen 610,968.14 apo 58.57% që është një trend jo i kënaqshëm por duke pas parasysh periudhën nëpër të cilën po kalojmë nuk jemi edhe shumë keq, realizimi i te hyrave për periudhën Janar shtator është 1,050,293.14€ apo 100.69%.Në kategorinë e investimeve kapitale kemi të alokuar shumëm prej 5,429,467.39 grant i performances se mirë i fituar nga Komuna ne vitin 2019 ndërsa sa i përket kontratave Kolektive si Sektori i Arsimit dhe ai i Shëndetësisë i kanë kushtuar buxhetit të komunës në vlere prej 116,174.94€ dhe atë nga kategoria Mallra dhe Shërbime .
Periudha nenet mujore ,pranimet të hyrat për shpenzime Kapitale kapin shumën prej 5,429,467 grante qeveritar 3,446,985.00€ ,granti i performances 328,500€ granti brendshëm 2,213.12 € dhe huaja 24,069.00€ këto ishin në pika të shkurtër nëse ka dikush diçka jam i gatshëm me u përgjigj.
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj kalojmë të pika e 4.** Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 12-400-40369,të datës. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit E hapim për diskutim pasi diskutime nuk pati .
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj -** hedhi në votim pikën e katërt të rendit të ditës : **Për votuan 18, Abstenim 2, Kundër-0**
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj** hapi për diskutim piken e pestë: **5.**Propozim Vendim shfuqizimin e Vendimit 12-400-40360, të dt. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit. Pasi diskutime nuk pati .
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-** hedhi ne votim ketë pikë të rendit të ditës.
**Për votuan 17, Kundër votuan 3, Abstenim 0.**
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- kalojmë te pikat e radhës:6** Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme ( njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc
7.Propozim Vendim për këmbimin e pronave të paluajtshme (ndjesive të ndërtesave-banesave) në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
**8.**Propozim Vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme ( njësive të ndërtesave – banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- këto tri pika votohen :**
**Për votuan 19, Kundër 3, Absteni 0.**
**Kryesuesi i Kuvendit Habinot Halilaj, hapi për diskutim pikën 9** .Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme të hekurudhave të Kosovës (Shoqëri Aksionare ) për parcelat nr. 953-1,961-0,956-0, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Drenas (Gllogoc).
**Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani** - Komuna e Drenasit/Gllogocit nëpërmjet Kuvendit Komunal ka miratuar Vendimin për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, ku është paraparë që në këtë pjesë të ketë ndërtim dhe zhvillim të infrastrukturës rrugore, ku do të bëhet zgjerimi i rrugës dhe zhvillimi i infrastrukturës përcjellëse në interes të qytetarëve të Komunës së Drenasit.
Andaj qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të këtyre pronave të Hekurudhave të Kosovës SH.A, Fushë Kosovë.
Për procedurat e mëtejme do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit, komfon dispozitave ligjore në fuqi.

Ekipi profesional i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka bërë inçizimin e kësaj pjese të pronës së shënuar më lartë ku do të bëhet realizimi i këtij projekti, për të cilën pjesë edhe janë nxjerrë kopja e planit dhe certifikatat e pronësisë.

**Sabrije Kukaj-** kishte qenë mirë me mëndu nëse ka hapësirë për parking për arsye se Drenasi është jashtëzakonisht i ngulfatur sa i përket parkingjeve ,dhe nëse ka hapësirë të diskutohet të arrihet një marrëveshje sa i përket edhe parkingut unë jam e njoftuar për këtë pjesën ë ka me u bere rruga katër korsi po kishte qenë mirë me menduar edhe për parking , nëse arrihet një marrëveshje me hekurudhat e Kosovës .
**Petrit Sinani-** esenca e fjalimit tim është ne lidhje me formulimin e këtij propozim vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik pronave të paluajtshme të Hekurudhave d.m.th ne me shpall propozim vendim për pronat e tyre vetëm për këtë deshta një sqarim faleminderit .
**Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-** i nderuar ne e shpallim interes të përgjithshëm këto prona të tyre , për Komunën sipas ligjit dhe rregullores.
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-** hedhi ne votim piken **9.**Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme të hekurudhave të Kosovës (Shoqëri Aksionare ) për parcelat nr. 953-1,961-0,956-0, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Drenas (Gllogoc.
**Për votuan 22 , Kundër 0 , Abstenim 0.**
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** -hapi për diskutim pikën 11. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës,të cilat janë nënë menaxhimin e AKP-së, në zonën Kadastrale Korroticë të Epërme.
**Fjalën e merr Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-**Shpallja me interes të përgjithshëm publik të këtyre pronave ka për qëllim bartjen e tyre nga menaxhimi i AKP-së në emër të Komunës së Drenasit, për realizimin e planit zhvillimor, ekonomik urbanistik dhe infrastrukturor 2020-2028.
Bazë juridike për bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës së Drenasit është Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Ligji Nr.06/L-092, ku neni 27 i këtij ligji thotë: (E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore).
Bartja e këtyre pronave në emër të Komunës është e domosdoshme për qytetarët e Komunës së Drenasit, për rritjen e mirëqenies socio-ekonomike.
Këto prona janë trajtuar në organet kompetente të Komunës dhe është dakorduar që kjo listë e parcelave duke e specifikuar gjendjen aktuale të tyre, arsyeshmërinë e Komunës së Drenasit të shfrytëzohen për nevoja të përgjithshme komunale, konform legjislacionit në fuqi.
Pas miratimit të këtij propozim vendimi, Kryetari i Komunës inicon procedurën e mëtejme për bartje konform dispozitave ligjore në fuqi.
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka bërë inqizimet e këtyre pronave dhe ka nxjerrë kopje të planit dhe çertifikata të njësive kadastrale.
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** faleminderit drejtor fjalën e merr:
**Sabrije Kukaj** -deshta të pyes a është në pjesën ku janë edhe bizneset tjera a po në anën e kundërt të rrugës ?
Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-** rreth e rreth pjesës mbrapa bizneseve që janë aktuale .

**Sabrije Kukaj** – e këtë pjesën poshtë kush e menaxhon për arsye se disa biznese që drejt në rrugë i kanë hap dyert e biznesit e kujt është ajo pronë dhe a ka mundësi inspektoret me intervenua aty .
Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani**-ato janë prona private.
**Sabrije Kukaj** –edhe në prona private nuk lejohet në rrugë a kemi inspektor?
**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**- nëse e ke fjalën për bizneset për gjatë rrugës M9 autostradës edhe kah Parku i Biznesit Drenasit I dhe kah pjesa tjetër Drenasi II ,ku do të ndërtohet parku i ri i biznesit kam vendos inspektoratin me u marr me atë çështje jo vetëm për me rrugën M9 por gjate gjithë rrugëve rajonale ,ndërsa në anën tjetër kah Kroin i Mbretit pronat që janë ndërrua jam duke i hetuar dhe shikuar ligjshmëritë e atyre pronave që kanë kaluar nga pronat komunale deri tek pronari , ju e dini se disa dokumente mungojnë se i ka marr Serbia po për ato dokumente që posedojmë do ti marrim për baze .
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hedhi në votim këtë pikë të rëndit të ditës, dhe kjo pikë u votua në mënyre unanime .
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hapi për diskutim piken 12.Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës për Kompaninë Fer Petrol.
Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj –pasi nuk pati diskutime hedhin në votim ,gjithashtu edhe kjo pikë u votua në mënyre unanime .
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hapi për diskutim pikën 13. Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës për Kompaninë Elkos shpk.
Nëse ka dikush diçka nëse nuk ka atëherë ju ftoi të votoni .
**Për votuan 21, Kundër 0 , Abstenim 2 .**
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hapi për diskutim piken **14.**Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës personit fizik Ragip Veseli
Fjalën e merr **Sabrije Kukaj** – Unë për pronën e Ragip Veslit në pjesën e Komoranit nuk e kam votua as ne komision për arsye për sigurimin me kompaninë e sigurimeve ka pasur vetëm për një muaj d.m.th. nuk ka qene projekti i siguruar gjate krejt kohës kur behën investimet dhe ne mbledhje kam qenë kundër për këtë. E dyta mua nuk me ka bind Ragip Veseli sipas pasqyrave bankare qe investon aq shume te mjeteve në atë pjesë për ketë arsye kam qene kundër dhe faktikisht edhe këtu jam kundër për ketë pronë.
Fjalën e merr Adem Bucolli - Kolege te nderuar. Pasi qe jam ne Komisionin e Ankesave për dhënien e pronave ne shfrytëzim te Kuvendit Komunal ne si komision me ketë rast po foli si komision në emër te gjithë kolegëve tone qe ne me për pikmëni i kemi shqyrtua te gjitha ankesat dhe i kemi analizuar mësuese ne kemi marre një vendim nga Banka Qendrore ku sigurimi bankar, sigurimi bankar është i baraz peshuar edhe sigurimi bankar sigurohet për një muaj ,30 ditë vetëm për ofertuesin pastaj sillet sigurimi bankar d.m.th i përgjithshëm i cili pas dhënies ne shfrytëzim qe te garanton investimin e investitorit.
Fjalën e merr **Sabrije Kukaj**- Sa i përket a janë të barabarta ne jemi sqarua edhe ne komision dhe unë kam informate qe janë te barabarta d.m.th edhe kompania e sigurimeve merr përgjegjësinë për me i barte shpenzimet nëse nuk kryhet projekti por faktikisht tek ky ka qene vetëm një muaj sigurimi bankar dhe pasqyrat financiare si person fizik nuk me kanë bindur që

mundet me i investuar 2 milionë euro, kjo ka qenë arsyeja por prapë se prapë vendimi i me shumë njerëzve është me i fuqishëm se çka unë ,mendoje.
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hedhin ë votim pikën **14.**Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës personit fizik Ragip Veseli
**Për votuan 22 , Kundër 0 , Abstenim 2 .**
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hapi për diskutim piken 15..Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës ,zona kadasatrale Arllat për Kompaninë IP Kos shpk.
Nëse nuk ka diskutime atëherë ju ftoi të votoni.
**Për votuan 22 , Kundër 2 , Abstenim 0.**
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hedhin ë votim piken 16.Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite te Pronës se Paluajtshme të Komunës zona kadastrave Gllogoc për Kompaninë IP Kos shpk.
Nëse nuk ka diskutime atëherë ju ftoi të votoni.
**Për votuan 23 , Kundër 1 , Abstenim 0 .**
**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- të pika te ndryshme nëse ka dikush diçka, Fjalën e merr :**Sokol Bylykbashi** – faleminderit kryesues me herët me erdhi një ankese prej një qytetari të lagjes Zariqi pra fshatit Baic ,ka të bëj me një rrugë atje që është shtruar nuk e di asfalt apo zhavorr problemi është që para dyerve e kanë lënë shumë keq e kam ,edhe foto mund të ia tregoi drejtorit ,sepse mënyra se si e kanë lënë rrugën është e pa pranueshme ,dhe nëse nuk gaboj ky problem është i ka me shumë se një muaj dhe kompania nuk është duke bërë asgjë për kundër premtimeve qe ja kanë bërë qytetarit që ky problem do të rregullohet sepse ai po ka pengesa me u fut ne oborr te vitin ashtu si duhet faleminderit.
**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** për shkak se drejtori nuk është këtu unë patjetër këtë shqetësim të këtij qytetari do të adresoi tek drejtori përkatës .
Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 30. min.

**Procesmbajtëse:**

**Fakete Hoti**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Labinot Halilaj**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kuvendit**

**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 19. 11 .2020, si vijon:**

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P .F-ca më rendin e ditës .
Nuk pati diskutime , u aprovua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët rendi i ditës me:

**Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 23.10.2020.
   **- Votuan 07,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***
2. Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
   **- Votuan 07,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***
3. Propozim Vendim për rrënimin e ish objektit të Komunës,si dhe objekteve tjera përcjellëse.
   **- Votuan 07,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***
4. Propozim Vendim për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale.
   **- Votuan 05,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 02***
5. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrate Gllogoc.
   **- Votuan 07,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***
6. Model Kodi i Etikës.
   **- Votuan 07,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***
7. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.
   **- Votuan 07,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***
8. Të ndryshme.

**Pasi spati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 15.**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY GLLOGOC

Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna Gllogoc**
Zyra e Kryetarit
**01-Nr**462/01- 48841 **dt.**10/11 **2020**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit nr. 03/L–040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), e në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/2019 ), e konform nenit 7 të Rregullores nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gllogocit, 01-nr.110-6904 të datës 24.09.2008. Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë ______ të miratojë këtë:

**RREGULLORE (_nr,_______) /2020**
**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen, kriteret kushtet dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për interes publik, për peridhën më pak se një vit.

### Neni 2
### Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e komunës, personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së.

### Neni 3
### Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin, siç është përkufizuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

## Neni 4
## Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1.Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:

1.1. **Parimi i ligjshmërisë** - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;

1.2. **Parimi i efikasitetit** - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;

1.3. **Parimi i trajtimit të barabartë të palëve** - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;

1.4. **Parimi i transparencës** - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;

1.5. **Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës** - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrën që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;

1.6. **Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës** - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

## Neni 5
## Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit

1. Komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës për me pak se një (1) vit.

2. Pronat e paluajtshme e komunës të cilat mund të jepet në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, janë:

2.1 Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese);

2.2 Shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot dhe terenet rekreative-sportive;

2.3 Hapësirat publike para lokaleve;

2.4 Lokalet në pronësi të komunës;

2.5 Hapësirat publike rreth vend punishteve.

3. Kompensimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit përcaktohet me rregullore të komunës për taksa komunale.

**Neni 6**
**Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:

1.1 Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastrale të pronës;

1.2 Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;

1.3 Të mos ketë ndonjë kontest pronësor;

1.4 Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor;

1.5 Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;

1.6 Të ketë arsyeshmërinë të interesit publik;

1.7 Të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë;

1.8 Të ndikojë në rritjen e vlerave e diversitetit arsimor, kulturore-sportiv e të ngjajshme.

## Neni 7
## Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit

1. Prona e paluajtshme e komunës jepet në shfrytëzim për peridhën më pak se një (1) vit për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes një kërkese zyrtare me shkrim.
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet organin kompetent, drejtorisë përkatëse:
   2.1. Për dhënien në shfrytëzim të hapsirave publike, kërkesa i drejtohet drejtorisë së Urbanizmit;
   2.2. Për dhënien në shfrytëzim për objektet kultorore, rinore dhe sportive, kërkesa i drejtohet drejtorisë për kulturë, rini dhe sport ;
   2.3. Për dhënien në shfrytëzim të lokaleve në pronësi të komunës, kërkesa i drejtohet drejtorisë përkatëse për pronë ;
   2.4. Për dhënien në shfrytëzim të hapsirave publike rreth vend punishteve, kërkesa i drejtohet drejtorisë për shërbimeve publike;

3. Prona e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së aplikuesit duhet të shfrytëzohet vetëm për destinimin e kërkuar.

## Neni 8
## Kushtet për aplikim

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marrë në shfrytëzim pronën e paluajsthme të komunës duhet të bashkangjesin këto dokumente:
   1.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara nga drejtoria përkatëse;
   1.2. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik ;
   1.3. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik ;
   1.4. Historiati i biznesit që aplikon ;
   1.5. Veprimtaria që do të zhvillojë;
   1.6. Projekti ideor ;
   1.7. Vërtetimi nga komunat për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe taksave komunale;

2. Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në apilikimin për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e drejtorisë përkatëse .

## Neni 9
## Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për Organizatat e shoqërisë civile

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së komunës për organizatat e shoqërisë civile për periudhën më pak se një (1) vit jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë rregullore.

2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile jepet nga një (1) ditë deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, arkitekturën historike, e të ngjashme.
3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlersues.
4. Organizatat e shoqërisë cilvile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e komunës mund të iu jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlersues.

**Neni 10**
**Formimi dhe përbërja e komisionit**

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për secilën drejtori e cila në bazë të kësaj regulloreje ka kompetencë dhe autoritet të jep në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës.
2. Komisioni do të ketë përbërje, prej tre (3) anëtarëve, ku kryesues i komisionit do të jetë zyrtari nga drejtoria së cilës i është drejtuar kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronë së paluajtshme të komunës, ndërsa dy anëtar mund të jenë nga drejtoritë tjera të fushave profesionale.
3. Komisioni ka për obligim që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës të bëjë shqyrtimin e kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike në teren, se a është në harmoni dhe përputhshmëri me arsyeshmërinë e kërkesës.
4. Pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni duhet të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë për palën përfituese
5. Mandati i komisionit do te jetë dy (2) vite .

**Neni 11**
**E drejta e ankesës**

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlersimit të kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave të komunës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave ;
3. Përbërja e komisionit do të jetë prej pes (5) anëtar, ku njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist, ndërsa të tjerët profesionist sipas drejtorive përkatëse.
4. Vendimi i komisionit të ankesave për miratimin apo refuzimin e ankesës së palës është përfundimtar në procedurën administrative në komunë.

5. Komisioni për ankesa brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të ankesës bën shqyrtimin e ankesës;

6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh (30) nga dita e marrjes së vendimit, mund të inicojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
7. Mandati i komisionit per shqyrtimin e ankesave do te jete dy (2) vite.

**Neni 12**
**Konflikti i interesit**

1. Anëtarët e Komisionit përjashtohen nga procesi vendimmarrës nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim te pronës së paluajtshme të komunës.
2. Anëtarët e Komisionit vlerësues përjashtohen nga procesi vlerësues nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankesave përjashtohen nga procesi i shqyrtimit të ankesave nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

**Neni 13**
**Nënshkrimi i kontratës**

1. Bazuar në rekomandimin e komisionit vlerësues dhe pas kalimit të afatit të ankesës, Kryetari i Komunës nënshkruan kontratën me të përzgjedhurin, në të cilën kontratë përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
2. E drejta e shfrytëzimit e pronës së paluajtshme të komunës më pak se një vit, nuk mund të bartet te personat e tretë.

## II. DISPOZITAT E VEQANTA

**Neni 14**
**Mbikqyrja e kontratës**

1. Drejtoria përkatëse bën mbikqyrjen e realizimit të kontratës se a është duke e shfrytëzuar pala sipas kushteve të kontratës.
2. Në rast të mos përmbushjes së kontratës, apo shmangies nga qëllimi për të cilën është marrë prona në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, drejtoria përkatëse do të pergatis raport perfundimtar me të cilin do të rekomandoj Kryetarin e Komunës për shkëputje të njëanshme te kontratës.
3. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të përgaditur nga drejtoria përkatëse dhe duke u bazuar në rekomandimin e dhënë do ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar shtatë (7) ditë para ndërprerjes së kontratës palën kontraktuese.

4. Komuna është e obliguar që të publikojë listën e pronave të cilat i kanë dhënë në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
5. Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim bëhët brënda shtatë (7) ditësh mga dita e nënshkrimit të kontratës.

**Neni 15**
**Mirëmbajtja e pronës së komunës**

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, janë të detyruar që ato t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar konform kontrtaës për shfrytëzim;
2. Personat fizik dhe juridik dhe të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të komunës, janë të detyruar të kujdesen për mbrojtjen e pronës së paluajtshme, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

## III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

**Neni 16**
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit te cilat bien ndesh me dispozitat e kesaj Rregullore.

**Neni 17**
**Konflikti me ligjin**

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme ne Republikën e Kosovës.

**Neni 18**
**Zbatimi**

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive të Komunës së Gllogocit.

**Neni 19**
**Hyrja në fuqi**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040 për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores-Nr-01/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas shpalljes në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

**ARSYETIM**

Asociacioni i Komunave të Kosovës përmes Kolegjiumit të Zyrtarëve ka hartuar "model-rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës", e cila rregullore plotëson ciklin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Të cilët kanë inkurajuar dhe i kanë rekomanduar Komunës së Gllogocit, të iniciojë procedurat për miratimin e kësaj model-rregulloreje dhe të veprohet konform Ligjit në miratimin e rregullores në fjalë.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**KOMUNA E DRENASIT**
**Zyra e Kryetarit**
**Nr. 01-** 350/05-48996 **, dt.** 10/11 **2020**

Në bazë të nenit 58 pika *h* të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ______________ 2020 të miraton këtë:

## PROPOZIM VENDIM
## PËR RRËNIMIN E ISH OBJEKTIT TË KOMUNËS, SI DHE OBJEKTEVE TJERA PËRCJELLËSE

### I

**Të MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për rrënimin e ish objekteve të Komunës së Drenasit, dhe lirimit të objekteve përcjellëse në zonën e objektit të vjetër të ish Komunës.

### II

Objektet të cilat propozohen për rrënim janë të ndërtuara në pjesën e parcelës 414/1, zona kadastrale Gllogoc:

-Objekti i vjetër i ish komunës si dhe objektet tjera përcjellëse, me etazh P+1, me sipërfaqe totale prej 1409 $m^2$.

-Objekti montazh i barakës me etazh P+0, në sipërfaqe prej, 340 $m^2$, e cila gjindet në oborrin e Komunës së Re.

-Objekt i vjetër, jashtë përdorimi (i cili është shfrytëzuar në të kaluaren si depo dhe garazhë për automjetet zyrëtare të asaj kohe), me etazh P+0, me sip.197 $m^2$.

-Objekt i pa përfunduar, me etazh P+2, me sip.355 $m^2$.

-Si dhe objektet e tjera duke përfshirë edhe memorialin (i cili do të zhvendoset në një lokacion tjetër).

### III

**Qëllimi** për rrënimin e këtyre objekteve, është ralizimi i Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.

**IV**

Obligohet Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit që të zbatoj procedurat për rrënim të objekteve të cekur në pikën paraprake dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që ti përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike dhe kadastrale konform dispozitave ligjore në fuqi.

**V**

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës.

**VI**

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit.

**VII**

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës se Drenasit.

**KRYETARI I KOMUNËS**
**Ramiz Lladrovci**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - GLLOGOC - MUNICIPALITY GLLOGOC

REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

**Nr.** 01-945/02-49497, **dt.** 12. 11. **2020**

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datë__________2020, të miratoj këtë:

## P R O P O Z I M   V E N D I M

### Për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale

### Neni 1

**TË MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale në Komoran dhe Gllogoc.

### Neni 2

**Parcelat që kërkohen të bashkohen dhe parcelizohen, janë si më poshtë:**

**Parcelat që do të bashkohen:**

- Parcelat nr.430/1,430/2, 436/0, 435/0, 434/0, 433/0, 431/0 si dhe pjesa e parcelës nr.414/1, të gjitha këto parcela janë në zonën kadastrale në Gllogoc.

**Parcelat që do të parcelizohen:**

- Pjesa e parcelës nr.414/1, është në zonën kadastrale në Gllogoc.
- Pjesa e parceles nr.4/111, e cila gjindet në zonën kadastrale në Komoran.
- Parcela nr.743/29, është në zonën kadastrale në Gllogoc.

### Neni 3

